

VENDIM
Nr. 331, datë 22.4.2015

PËRMBROJTJEN E VEÇANTË TË PUNONJËSIT TË POLICISË QË, PËR SHKAK TË DETYRËS, I KËRCËNOHET JETA, FAMILJA DHE PRONA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 72, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Policia e Shtetit siguron mbrojtje të veçantë për punonjësin e policisë, që, për shkak të detyrës, i kërcënohet jeta, familja dhe prona.
 2. Me mbrojtje të veçantë do të kuptohen masat me karakter organizativ dhe profesional për ruajtjen fizike të punonjësit të policisë.
 3. Masat e mbrojtjes së veçantë janë:
 - a) ruajtje fizike;
 - b) ruajtje e familjarëve, banesës dhe pronës.
 4. Me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit ngrihet Komisioni i Vlerësimit të Kërcënimeve (KVK) për vlerësimin e kërkesave, miratimin e masave të mbrojtjes, ndryshimin, revokimin ose përfundimin e tyre, si dhe struktura përgjegjëse për zbatimin e masave të mbrojtjes së veçantë, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.
 5. Shpenzimet për realizimin e mbrojtjes së veçantë përballohen nga buxheti i miratuar për Drejtorinë e Policisë së Shtetit.
 6. Vendimi nr. 38, datë 26.1.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për një mbrojtje të veçantë të personave, që ndihmojnë policinë dhe të punonjësve të policisë, që u kërcënohet jeta, familja, prona, për shkak të detyrës”, shfuqizohet.
 7. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama